

VENDIM
Nr. 215, datë 31.3.2021

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE, NË BASHKITË LEZHË DHE
KURBIN, DHE CAKTIMIN E TYRE SI NJËSI ZBATUESE**

(ndryshuar me VKM nr. 771, datë 12.12.2022; nr. 694, datë 6.12.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021” të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 716 338 013 (shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e treqind e tridhjetë e tetë mijë e trembëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të njësive individuale të banimit, të cilat janë klasifikuar si objekte që duhen ndërtuar nga e para, në bashkitë Lezhë dhe Kurbin, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Lezhë i transferohet fondi, në masën 89 175 467 (tetëdhjetë e nëntë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, për rindërtimin e 42 (dyzet e dy) njësive individuale të banimit;

b) Bashkisë Kurbin i transferohet fondi, në masën 627 162 546 (gjashtëqind e njëzet e shtatë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind e dyzet e gjashtë) lekë pa TVSH, për rindërtimin e 225 (dyqind e njëzet e pesë) njësive individuale të banimit.

2. Përdorimin e fondit të rindërtimit për vitin 2021, në masën 143 267 602 (njëqind e dyzet e tre milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e dy) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të njësive individuale të banimit, të cilat janë klasifikuar si objekte që duhen ndërtuar nga e para, në bashkitë Lezhë dhe Kurbin, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Lezhë i transferohet fondi, në masën 17 835 093 (shtatëmbëdhjetë milionë e tetëqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar;

b) Bashkisë Kurbin i transferohet fondi, në masën 125 432 509 (njëqind e njëzet e pesë milionë e katërqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind e nëntë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, në masën 55 850 000 (pesëdhjetë e pesë milionë e tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, pa TVSH, për financimin e rindërtimit të njësive individuale të banimit, të cilat janë klasifikuar si objekte që duhen ndërtuar nga e para, në Bashkinë Kurbin, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe i transferohet Bashkisë Kurbin, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

2/2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, në masën 237 208 329,42 (dyqind e tridhjetë e shtatë milionë e dyqind e tetë mijë e treqind e njëzet e nëntë presje dyzet e dy) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të njësive individuale të banimit, të cilat janë klasifikuar si objekte që duhen ndërtuar nga e para, në Bashkinë Kurbin, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, dhe i transferohet Bashkisë Kurbin në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Caktimin si njësi zbatuese të bashkive Lezhë dhe Kurbin për rindërtimin e njësive individuale të banimit, të cilat janë klasifikuar si objekte që duhen ndërtuar nga e para, sipas pikave 1, 2, 2/1 dhe 2/2 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Lezhë e Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe